



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 5567 /2019  
Data: 24.06.2019

**PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e gjashtë -VI- për vitin 2019 e Komitetit për Politik dhe Financa, mbajtur me datë 18.06.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Sevime Laçi (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergencë), Medina Imishti (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Bashkim Sopa (Zyrtarë për Transparencë), Përfaqësuesi i OSB-së. Kryesuesi pasi konstataoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstataoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politik dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i kornizës afatmesme buxhetore 2020-2022.
3. Informatë për sektorin e emergjencave.
4. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

**MIRATOHET RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutim, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

**MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

2. Shqyrtimi i kornizës afatmesme buxhetore 2020-2022.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- si ekzekutiv i komunës e kemi punuar kornizën afatmesme buxhetore duke u bazuar në qarkoren buxhetore që është dërguar nga ministria. Korniza buxhetore përmban grantin e përgjithshëm, Grantin specifik për arsim, grantin specifik për shëndetësi, financimin për shëndetësinë sekondare, projekcionet e të hyrave vetanake nga komunat. Pjesa e dytë ka të bëjë me objektivat e komunës për vitet 2020-2022. Pjesa e tre ka të bëjë me deklaratat për misionin dhe përformancës sipas drejtorive. Korniza buxhetore është një dokument bazik i nivelit të lartë strategjik që pasqyrohet në suaza të

pergjithshme të hyrat dhe shpenzimet buxhetore si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike. Buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020 është në lartësi prej 2,742,095 €, ndërsa projekcionet për vitin 2021 janë në shumë prej 2,846,397 € dhe për vitin 2022 janë në shumë prej 2,958,963 €. Mjetet nga financimi qeveritar (granti i përgjithshëm, granti i arsimit dhe i shëndetësisë) janë në shumë prej 2,424,230 €, që shënojnë pjesëmarrje në shumë prej 88.41%, ndërsa nga të hyrat vetanake komunale në shumë prej 317,865 € apo 11.59%. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2020 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje: Paga dhe mëditje 1,789,897 €, Mallra dhe shërbime 283,234 €, Shpenzime Komunale 57,832 €, Subvencione dhe transfere 66,000 € dhe Shpenzime kapitale 545,132 €. Buxheti për vitin 2020 do të jetë më i vogël për shkak se deri në vitin 2019 kanë përfituar 14 komuna të cilat ishin nën 22 000 banorë dhe këtë buxhet nuk do ta kemi përveç nëse ndryshon me Ligin e Financave të Pushtetit Lokal. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- pse buxheti për vitin 2020 do të jetë më i vogël në krahasim me vitin 2019 ? Buxheti a përputhet me planifikimet dhe objektivat e kryetarit të komunës ? Cili është objekti më madhorë me prioritet në Han të Elezit brenda këtyre tri viteve .

**Nuriman Kuka** thekson:- si komunë e Hanit të Elezit nuk kemi mbështetje prej nivelit qendrorë dhe përveç kryetarit të komunës i cili mundohet ne tjerët jo. Në kuvendin e Republikës së Kosovë asnjë herë nuk e ka përmendur Hanin e Elezit askush prej deputeteve gjatë diskutimeve pavarësisht se për çka. Kur është koha e fushatës vijnë dhe i kërkojnë votat por asnjëherë nuk interesohen për me ndihmuar Hanin e Elezit. Projekte madhore ka Hani i Elezit por mjete financiare nuk ka.

**Rufki Suma** thekson:- ka qenë vendim i ish kryeministrit të Kosovës z.Isa Mustafa që me i ndihmuar komunat e vogla dhe kanë përfituar 14 komuna buxhet shtesë dhe në këtë vit përfundon. Në asociacion të komunave të Kosovës do të bëjmë kërkësë zyrtare që përsëri me u vazhduar për shkak se ka qenë buxhet shtesë. Qarkoren buxhetore e kemi diskutuar , mirëpo kur të miratohet buxheti për vitin 2020 do të bisedojmë më konkretisht. Në përfundim është faza e projektit për shtëpinë e kulturës. Kanë përfunduar procedurat e prokurimit për sallën e sporteve në shkollën filllore “Kështjella e Diturisë”. Salla e sporteve te shkolla filllore “Veli Ballazhi”. Terrenet sportive do të rregullohen te ish objekti i armatës dhe sala e sporteve. Do të vazhdohet me realizimin e projektit “Bllaca 99” që do të financohet nga qeveria. Projekt i shtratit të lumit “Lepenc” planifikohet të rregullohet por do të shikohen mundësítë përmes donacioneve të ndryshme. Për momentin te ngritja e pagave është llogaritur sikur na me i zgjedhur projektet kapitale në mënyrë që me u përfshirë mjetet financiare për paga dhe për momentin jemi në minus por qeveria nuk besoj që prej projekteve kapitale e bënë ngritjen e pagave por besoj që me buxhet shtesë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- te ngritja e pagave nuk besoj që involvohet buxheti i komunës për shkak se qeveria i ka parasysh këto gjëra. Duhet të jetë përputhshmëria e planifikimeve sipas periudhave me planin e kryetarit të komunës dhe buxhetin. Objekti i çerdhes ka kohë që është përfunduar dhe një vit shkollorë ka përfunduar në krahasim me përfundimet e punëve , mirëpo nuk është funksionale dhe është një planifikim i keç. Më mirë ishte dashur me planifikuar diçka tjetër dhe me qenë në funksion se sa me ndërtuar një objekt dhe mos me funksionuar. Si objektiv e pashto që do të përkrahen OJQ-të mirëpo sa janë përkrahur deri tash OJQ-të dhe cilat janë ato OJQ të cilat janë përkrahur ? Është planifikuar zhvillimi i turizmit rural mirëpo sa përputhet si objektiv me buxhetin e komunës . Është mirë me pasur kujdes sepse po përgatisim letra të mjaftueshme por nuk e kanë efektin siç duhet me pasur. Kur është përgatitur plani i punës së kryetarit të komunës nuk e kam votuar sepse kam menduar që nuk munden me u realizuar siç janë paraparë në letër për shkak se po përcillen vit pas viti dhe nuk po realizohen. Më pak objektiva por të realizohen sepse në fillim të mandatit kam potencuar se do ta përkrahi çdo projekt që është në interes të qytetarëve e jo vetëm me paraqitur letra.

**Rufki Suma** thekson:-projekti i çerdhes ishte planifikim shumë me vend dhe i mirë dhe është bërë shumë mirë që është ndërtuar por ka qenë neglizhencë e ministrisë për shkak se kemi bërë kërkësë si komunë. Në takimet që i kemi pasur tash është garantuar se me buxhetin e vitiit 2020 do të hapet çerdhja.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- unë nuk potencova se jam kundër projekteve por është shpenzuar një shumë e mjetete financiare te çerdhja pa hyrë në funksion dhe çështja e projektit të ujësjellësit do të ishte prioritet mbi prioritete për shkak se kemi problem. Projekti "Bllaca 99" mu dukë që është sa me thënë që kemi bërë diçka, sa me u parë në televizion dhe me u bërë mediatike. Besoj që ishit te "Bllaca 99" dhe e shihni se në çfarë gjendje është dhe fajin mundemi me ja lënë kujtdo dhe nuk është me rëndësi se kush e ka fajin sepse e keçja është se nuk është në rregull dhe për atë po them që me marr masa për me funksionuar e jo vetëm formalitet.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa).

#### U VOTUA KORNIZA AFAT MESME BUXHETORE 2020-2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

##### 3. Informatë për sektorin e emergjencave.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Refet Kalisi** thekson:- nuk kemi pasur ndonjë problem të theksuar sa i përket emergjencave. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund ta parashtroni.

**Nuriman Kuka** thekson:- e përgëzoj drejtorin për punën që ka bërë sepse vazhdimisht është në lëvizje për t'i kryer punët.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është mirë të përmirësohet sepse ka disa gabime drejtshkrimore dhe është mirë të përmirësohen për mbledhje të kuvendit të komunës. Është mirë të vendosen mbrojtëse nga mbikalimi në drejtim të rrugës që shkon ka Ura e Seçishtës për shkak se është një rrezikshmëri për fëmijët.

**Nora Xhoni** thekson:- rruga që shkon në drejtim të fshatit Gorancë te z.Nexhmedin Fida duhet të vendoset një rrethojo për shkak se është rrezik për fëmijët.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa).

#### U VOTUA INFORMATATA PËR SEKTORIN E EMËRGJENCAVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

##### 4. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- ligji është miratuar në vitin e kaluar dhe ende nuk ka filluar me u zbatuar për shkak se Ministria e Planifikimit ende nuk i ka harmonizuar udhëzimet administrative dhe janë të nevojshme edhe trajnimet për zyrtarët. Unë nuk i di arsyet se pse janë vonuar dhe shpresojmë që në këtë vit ndoshta do të fillojnë. Sipas regjistrimit të vitit 2014 më shumë se 2000 ndërtime pa leje janë në Han të Elezit

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa).

#### U VOTUA INFORMATATA MBI PROCESIN E TRAJTIMIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE DHE LEGALIZIMIN E TYRE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në ora 11:40

Procesmbajtësi

Ayni Bushi

Kryesuesi i Kuvendit

MSc. Qamush Brava